

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës nr.2 “Për vendosje sanksioni administrativ”, ankues: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.L.Braho.
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Meta, E.Mema.
- **Të tjerë:** Z.Erjon Huta, sekretar i KQV nr.0939, KZAZ NR.17

Z. E. Çefa: Përshëndetje, hapim seancën e vlerësimit paraprak të elementëve të formës të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve regjistruar me nr.2 me objekt: vendosjen e sanksioneve administrative ndaj sekretarëve të komisioneve të qendrave të votimit sipas lidhjes nr.3 që i bashkohet vendimit të Komisionerit nr.470, dt.3.12.2021. Në këtë vendim bëhet fjalë për vendosje sanksioni për 32 persona sipas listës bashkëlidhur. Në këtë seancë do të bëhet vlerësimi paraprak vetëm për sa i përket elementëve të formës, të përmbajtjes dhe legjitimitit të palëve. Në përfundim të kësaj seance KAS do të caktojë dhe datën e shqyrtimit në themel të çështjes, ku sigurisht palët e interesuara do të kenë të drejtën për t’u shprehur, si dhe për të dëgjuar pretendimet e Komisionerit. Kjo seancë drejtohet nga unë, në cilësinë e relatorit. Janë prezent përfaqësuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi i tij. Është prezent gjithashtu, besoj në cilësinë e personit të interesuar, ju lutem prezantohuni me mikrofon.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.12.2021*

Z. E. Hutra: Përshëndetje, sekretari i KQV nr.0939 të KZAZ-së Nr.17, Erjon Hutra, Qarku Dibër.

Z. E. Çefa: Më falni administrata...

Z. Y. Merkaç: Tek lidhja 3 është nr.18.

Z. E. Çefa: Dakord! Prezent persona të tjerë nuk ka! Shkurtimeisht ftojme Sekretarin e Përgjithshëm për të bërë një parashtrim të rrethanave të faktit, shkurtimeisht!

Z. Y. Merkaç: Referuar nenit 167 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka urdhëruar administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të bëjë këqyrjen me qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit dhe vlerësimit të numërimit të votave. Në përfundim të procesit të këqyrjes, duke u marrë në konsideratë problematikat e evidentuara dhe referuar në raportin e miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, u rekomandua marrja e masave organizative në të cilat synohet rritja e efikasitetit vendimmarrës dhe administratës zgjedhore të nivelit të tretë. Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se nga ana e sekretarëve të qendrave të votimit, nuk është plotësuar në tërësinë e tij libri i protokollit të mbledhjeve. Referuar nenit 41 të Kodit Zgjedhor, sekretari i KQV-së në detyrat kryesore të tij përgjigjet edhe për vendosjen e materialeve zgjedhore, në kutinë e materialeve zgjedhore, si dhe regjistrimin në librin e protokollit të mbledhjeve. Duke konstatuar se këto shkelje janë kryer nga sekretarët e KQV-ve, në vendimin nr. 470 të KSHZ, pika nr.3 i është rekomanduar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për marrjen e sanksioneve administrative në masën 30 mijë lekë që është minimumi i parashikuar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.12.2021**

nga dispozita ligjore, neni 171 i Kodit Zgjedhor. Kërkesa nga ana formale është në përputhje me nenin 130 të Kodit Zgjedhor, si dhe nenin 35 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ku është referuar për procedurë konkrete të hetimit administrativ, është vendosur baza ligjore, është bërë një përshkrim i shkurtër i shkeljeve, rrethanat e kryerjes së shkeljes. Janë parashikuar të dhëna nëse shkelësi rezulton përsëritës për shkeljen si dhe është vendosur rëndësia e shkeljes, parregullsia e mbarëvajtjes, pasojat që kanë ardhur nga veprimet, ose mosveprimet e sekretarëve të KQV-ve si dhe dokumenti provues që vërteton kryerjen e shkeljes së pretenduar. Gjithashtu në fund është dhe masa e sanksionit administrativ propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Duke parë në tërësinë e kërkesën, mendojmë që i plotëson kërkesat e neni 130 të Kodit Zgjedhor, pasi kompetenca është e KAS-it, legjitimimi i Komisionerit për të bërë kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ si dhe respektimi i afateve ligjore, faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Zoti Hutra besoj se e keni kuptuar qëllimin e kësaj seance?! Në këtë kontekst, në qoftë se keni diçka për procedurë mund të ju jap fjalën, në rast të kundërt pastaj do të keni mundësinë sigurisht, të shpreheni në seancën tjetër që KAS do të vendosë.

Z. E. Hutra: Jo nuk kam!

Z. E. Çefa: Në rregull, nuk ka gjë për të thënë. Edhe unë në cilësinë e relatorit, pa dashur të përsëris, konstatoj se kërkesa këtë rradhë është në përputhje të plotë me nenin 19 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 35 të rregullores. KAS-i është organi kompetent për shqyrtimin e saj. Komisioneri legjitimohet në këtë kërkim, bazuar në nenin 19 të Kodit Zgjedhor, po ashtu kjo kërkesë vjen brenda afateve të përcaktuara

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.12.2021*

në rregulloren e KAS-it. Si përfundim, në këtë kontekst, unë i propozoj KAS-it që ta kalojmë në seancë të themelit këtë çështje. Dakord?

Atëherë jemi dakord! Unë propozoj datën 5 janar ora 13:00? Për ju zoti Hutra, dakord? Në rregull!

Z. I. Rusmali: Mund të shtoj diçka për administratën e KQZ-së? Me sa shoh unë këtu, ju keni dhënë një raport për shkeljet e konstatuara. Ne do të kemi në shqyrtim 32 raste dhe do të na duhen shkeljet konkrete për secilin rast se ndryshe nuk ka kuptim procedura jonë. Kur të jemi në seancë duhet të na raportoni për secilin rast kush është shkelja konkrete që të mund të procedojmë.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, bashkëlidhur vendimit 470 të KSHZ, në lidhjen nr.2 janë parashikuar sekretarët e qendrave të votimit të cilët nuk kanë administruar librin e protokollit të mbledhjeve dhe pjesa tjetër e sekretarëve që e kanë dorëzuar librin e protokollit të bardhë.

Z. L. Braho: Këto bashkëlidhur janë procesverbalet e emërimit?

Z. Y. Merkaj: Aneksi nr.2, bashkëlidhur vendimit nr.470 të KSHZ, “Gjetjet e kqyrjes”, mungesat e librave të protokollit dhe mungesë shënimesh. Është në fund të raportit. Gjithashtu janë bashkëlidhur tek kërkesa e KSHZ edhe gjetjet e GNV këtu në KQZ që kanë konstatuar mangësitë e cituara më sipër.

Z. E. Çefa: Dakord! Ju faleminderit të gjithëve, seanca deklarohet e mbyllur!

Vendimi nr. 116

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

